



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.13921 prot.

Lezhë, më 19.08.2024

### **SHPLLJE PËR VEND TË LIRË PUNE**

Bazuar në nenin 55/1, në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2020 “Procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të Drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar”, shkresës nr.13334 prot., datë 05.08.2024 të Drejtorisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me lëndë “Dërgim Urdhëri”, Urdhërit nr.3 datë 03.01.2024 “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e Bashkisë, të Njësive Administrative, të institucioneve vartëse dhe punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2024”, Bashkia Lezhë njofton shpalljen e konkurimit për vend të lirë pune në pozicionin:

#### **1. Drejtor i Drejtorisë së Kopështit “Hirushja”, Bashkia Lezhë.**

##### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:**

1. Të kenë arsim të lartë në profilin “Arsim parashkollor”.
2. Të kenë të paktën 5 vjet punë si mësues i arsimit parashkollor.
3. Të jetë trajnuar dhe pajisur me çertifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar.

##### **Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë , dokumentacionin si më poshtë:**

1. Jetëshkrim.
2. Raport mjeko- ligjor.
3. Deklaratë për gjendjen gjygjësore.
4. Vërtetim i qëndrës së banimit.
5. Librezën e punës.
6. Kopje të njësuar me origjinalin të diplomës.

## **AFATI I DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE ( 28.08.2024)**

Dokumentat duhen të dorëzohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse brenda datës 28.08.2024, ose nëpërmjet postës.

Kandidatët do të vlerësohen me konkurim të hapur nga Komisioni i Vlerësimit, i ngritur sipas parashikimeve të nenit 55/1,të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpallje do njoftohen me e-mail për datën e zhvillimit të konkurimit, si dhe kandidatët e skualifikuar do njoftohen me e-mail për arsyet e skualifikimit .

**KRYETARI**  
**Pjerin Ndreu**